



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 34.
Prishtinë, më 6.03.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lirije Kajtazi, Mufera Sinik, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic dhe Etem Arifi.

Munguan: Elmi Reçica, Lumnije Morina, Glauk Konjufca dhe Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Elita Vokshi, Florina Shala përfaqësues nga zyra e ICO-së Dejan Cosic, përfaqësues nga zyra e KDI-së Shkumbim Beqiri, përfaqësues nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-80 për lojërat e fatit, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë votash, me një të përmbajtur, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi – thksoi së në mbledhje të komisionit të datës 21.02.2012 ka marrë pjesë edhe Jasmina Zivkovic dhe propozoi që i njëjti të plotësohet me këtë vërejtje .

Ai konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve së datës 21.02.2012 me ndryshim të cekur më lartë.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 24.02.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-80 për lojërat e fatit, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet në shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit **nr. 04/L-80 për lojërat e fatit**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit nr. 04/L-80 për lojërat e fatit dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të propozuara nga Komisioni funksional dhe nëse nuk ka vërejtje eventuale, kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet në shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit **nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente.

Qëndrimi i tij ishte se përbërja e Këshillit Drejtues të Bibliotekës Kombëtare shkelen të drejtat e komuniteteve sepse nuk është parashikuar që në Këshill të jetë një përfaqësues i komunitetit jo shumicë. Kjo kërkesë ka dalë nga grupi SLS dhe grupit 6+.

Jasmina Zivkovic – kishte vërejtje konkrete në nenin 9. në Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Në bazë të këtij neni Këshilli Drejtues i Bibliotekës Kombëtare është në përbërjen prej 5 anëtarëve, të cilët emërohen nga Ministri i Kulturës dhe prej pesë anëtarëve një anëtarë do të jetë përfaqësues i Ministrisë.

Ajo konsideron se me këtë nen shkelen të drejtat e komuniteteve me arsyetim se Këshilli drejtues nuk parasheh që një përfaqësues të jetë i zgjedhur nga radha komunitetit jo shumicë.

Në këtë drejtim ka dhanë propozim amendamentin GP –SLSD dhe GP – 6+ për ndryshimin e përbërjes së Këshillit drejtues dhe se i njëjti nuk është miratuar nga komisioni Funkcional.

Ajo qëndron pran propozimit që përbërja e Këshillit drejtues të plotësohet me një paragraf të ri, me riformulim: një prej pesë anëtarëve të jetë i zgjedhur nga komuniteti pakicë.

Petar Miletic – pajtohet me diskutimin e parafolësës lidhur me përbërjen e anëtarëve të Këshillit drejtues. U përqendrua në çështjen se vetëm me ligj mund të rregullohet që Këshilli drejtues i Bibliotekës Kombëtare të kenë një përfaqësues të komunitetit jo shumicë.

Ai ceku se në propozim amendamentin e GP- SLS dhe GP- 6+ nuk është precizuar përfaqësimi i cilit komunitet do të jetë anëtar i këshillin drejtues. Njëherit nuk kundërshton të drejtën që në këtë këshill të ketë të përfaqësuar edhe një anëtar të komunitetit pakicë.

Albert Kinolli - në plotësi përkrahë propozimin e parafolësve se në Këshillin drejtues duhet të jetë i kyçur një anëtar i komuniteteve jo shumicë.

Ai shpreh mendimin e tij se kur është fjala për Projektligjin për Bibliotekat në Republikën e Kosovës mirë është që Këshilli drejtues të emërojë edhe një anëtar të komunitetit pakicë.

Ai kërkoi që në këtë komision të definohet saktësisht që zgjedhja nga pesë anëtarët e Këshillit drejtues, një të jetë përfaqësues i komunitetit serb dhe një nga komunitetit pakicë. Ishte i mendimit që anëtari i komuniteti pakicë të zgjidhet me rotacion.

Myfera Sinik - ajo ceku se amendamenti i propozuar nga grupi SLS dhe grupit 6 + , duhet të jetë i harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet bazike.

Në diskutimin e saj tha se në Këshillin drejtues se përbërja prej pesë anëtarëve, një anëtarë të jetë përfaqësues i komunitetit serb dhe një nga komunitetit pakicë (jo shqiptar dhe jo serb).

Lirije Kajtazi – në fjalinë e saj tha se, vërejtje të shumta ka pas në Kuvend edhe gjatë leximi të parë të Projektligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës. Interpretimi i Ministrisë së Financave dhe vërejtjeve të disa deputetëve ka qenë lidhur me çështjen e kostos financiare. Sidomos kur bëhet fjalë për rritjen e numrit të anëtarëve në këshillat drejtuese, Ministri i financave e ka lënë mundësinë varësisht nga kostoja financiare e jo si detyrim. Ajo ishte e pajtimit për ndryshimin e përfaqësimit të anëtarëve në Këshillin drejtues.

Myfera Sinik – Në kuadër të respektimit të drejtave të të gjitha komuniteteve, ajo ishte e mendimit që amendamenti i GP- SLS dhe GP- 6+ të ndryshohet dhe plotësohet në këtë përbërje Këshilli Drejtues i Bibliotekës Kombëtare të jetë në përbërje prej (7) shtatë anëtarëve.

Petar Miletic – në bazë të diskutimeve të shumta ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për takimin e radhës. Ndërkaq, në vijim anëtarët e GP- SLS dhe GP- 6 + do të mbajnë takim të përbashkët, me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve të të dyja grupeve parlamentare. Më pas do të dilet me riformulim të amendamentit final i cili do të miratohet në komision dhe të iniciohet në procedura të mëtejme.

Kryesuesi – konstatoi se pas diskutimeve lidhur me propozim amendamentin e Grupit Parlamentar SLS dhe Grupi Parlamentar 6 +, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve me shumicë të votave, nxori këtë:

Përfundim

- I. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës me Raport të Komisionit funksional, shtyhet për mbledhjen e radhës.
- II. Grupi Parlamentar SLS dhe Grupi Parlamentar 6 + do ti harmonizojnë qëndrimet e tyre dhe do të dal me propozim amendament konkret i cili do të miratohet në këtë komision dhe i njëjti do t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit Funksional.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-94 për shërbimet e shoqërisë informatike dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme.

Në mbledhje kishte reagime lidhur datën e vizitës në KK Ranillug dhe KK Shtërpce nga Z, Lirije, Znj, Jasmina dhe znj Jelena, Arsyeja ishte që vizita të shtyhet për një datë tjetër, nga se në të njëjtën ditë kanë takime të rëndësishme të veçantë Parlamentare.

Kryesuesi - konstatoi se me kërkesë të anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për arsye të angazhimeve Parlamentare, takimi i vizitës me datën 7.03.2012 në Kuvendin Komunal Ranillug dhe Komunën e Shtërpces është shtyre për javën e ardhshme. Për takim dhe agjendën e vizitës do të njoftoheni me kohë.

Kryesuesi, - vërejtje të veçantë kishte se gjatë shqyrtimit në Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë, nuk janë shqyrtuar propozim amendamentet e anëtarit të komunitetit jo shumicë dhe anëtarit të GP 6+, me apo pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL. Ai shtoi se kjo formë nuk është zgjidhje e drejtë Parlamentare.

Petar Miletic- me theks të veçantë tha se detyrat tona nuk janë vetëm të konstatohet ana procedurale në shkeljen e të drejtave të komuniteteve por si obligim është që sipas strategjisë legjislative të shqyrtohen të gjitha ligjet.

Në diskutimin e tij tha se propozim amendamentet e deputetit Enis Kervan të paraqitur në komisionin FunkSIONAL për Arsim nuk janë miratuar me apo pa përkrahje dhe konsideron se kjo mënyrë e procedimit është shkelje procedurale . Ishte i mendimit që këtë çështje duhet diskutuar edhe një herë me kryetarin e komisionit FunkSIONAL. Njëherit kërkoi që kjo çështje të iniciohet me shkrim te kryeparlamentari i Kuvendit.

Kryetari i komisionit për Komunitete dhe Kthim në emër të GP SLS dhe GP 6+ deklarohet se do të drejtohet me shkrim te Kryeparlamentari i Kuvendit të Republikës së Kosovës për arsye të mosrespektimit të procedurave Parlamentare në kuadër të Komisioneve Parlamentare dhe se këtë çështje do ta ngrit edhe në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic